



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

## Menaxhimi i Kapitalit Njerëzor dhe Lidershipi në Biznes EKM0017

Bartësi i lëndës:	Durim Hoxha
Email:	durim.hoxha@riinvest.net
Telefoni:	

### Hyrje

Ky kurs ka për qëllim të pasqyrojë rëndësinë e Burimeve Njerëzore, ndërlidhjen me politikën biznesit dhe strategjinë konkurruese të organizatave. Qëllimi është që tu ofrohet studentëve një materje e cila e ngritë kompetencën e tyre, atë që nevojiten atyre, dhe atë që është e nevojshme për organizatat; Ky kurs ka të bëjë me hartimin dhe ekzekutimin e strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky kurs ka dy tema qendrore: (1) Si të mendohet sistematikisht dhe strategjikisht në lidhje me aspektet e menaxhimit të aseteve të organizatës sikur janë burimet njerëzore të organizatës dhe (2) Çfarë duhet bërë vërtet për të zbatuar politikën zhvillimore dhe motivuese për rritur pozitën konkurruese të organizatës. Shumë autor që merren me studimin e menaxhimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, pranojnë se burimet njerëzore janë burim kritik të cilët organizatës i sigurojnë përparësinë konkurruese. Tani më asetet tjera të cilat i posedon organizata sikur; dizajni i produktit, marketing, teknologjia gjithësesi kanë rëndësi, mirëpo rëndësi qendrore kanë burimet njerëzore me diturinë, përvojën aftësinë shkathtësinë e tyre në materializimin e të gjitha burimeve tjera, në produkte dhe shërbime të gatshme. Përmbajtja e kursit që do tu ofrohet studentëve të këtij niveli është me rëndësi për shkak të ndryshimeve të shpejta të cilat janë duke ndodhur në rrethinë, ritmi i shpejtë i ndryshimeve teknologjike, rritja e konkurrencës globale, etj. Prandaj në këtë ambient studentit do t'i ofrohet mundësi që nëpërmjet këtij kursi të zhvillojë njohuritë e veta nga pikpamja e organizimit dhe pozitës së ndërmarrjes në treg, strukturës organizative të sajë dhe nevojës për ndryshime të cilat kërkojnë investime në faktorin njerëzor, në dituritë e tij, dhe në vet procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore në organizatë dhe të diturisë së tij.

### Qëllimet

1. Përgatitja studentëve që të kuptojnë krejt cka ofron ky program 2. Mundësia që studentët të njohin dhe fitojnë aftësi për tu përballur me sfidat me të cilat ballafaqohet menaxhimi bashkëkohor i burimeve njerëzore 3. Njohja me rëndësinë menaxhimin e burimeve njerëzore që shehet si një qasje dhe asset thelbësor i strategjisë së përgjithshme organizatës 4. Zhvillimi i njohurive, aftësive të cilat kërkojnë organizatat dhe menaxhmenti i sajë për menaxhimin me sukses të burimeve njerëzore dhe të strukturës së burimeve njerëzore 5. Do të përgaditë studentët që të njohin dhe përvetësojnë mënyrën e identifikimit dhe të definimit të burimeve njerëzore, analizës së nevojave të burimeve njerëzore sipas kërkesave të organizatës, si dhe aplikimin e procesit menaxhues për; si rekrutimi, përzgjedhja, motivimi, menaxhimi i diturisë në organizatë, vlerësimi i performancës dhe kompensimi.

### Rezultatet e pritura të lëndës

- Të demonstrojnë dhe kuptojnë funksionet e menaxhimit të burimeve njerëzore.  
Të jenë në gjendje të analizojnë gjendjen ekzistuese të organizatës, ndryshimet e nevojshme të cilat janë si nevojë e ndryshimeve në rrethinë e brendshme dhe atë të jashtme. Të jenë në gjendje të kuptojnë dhe menaxhojnë sjelljen në organizatë, dhe faktorët të cilët janë pjesë e burimeve njerëzore, dhe departamentit të organizatës,
- përkatësisht pjesë e suksesit të sajë.  
Reflektojnë dhe të vlerësojnë procedurat dhe praktikën e vlerësimit, marrëdhëniet e punës, dhe aspektet disiplinore të menaxhimit të burimeve njerëzore me raste studimore në literaturë dhe nga Kosova
- Demonstrojnë një kuptim të teknikave për integrimin e suksesshem të të punësuarve në grupin e punës

- Që studentët e këtij niveli të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe zbatojnë funksionet e menaxhimit të burimeve njerëzore; rekrutimin, përzgjedhjen, motivimin, orientimin në punë, punën ekipore, ndërtimin e strategjive dhe zbatimin e tyre , menaxhimin e dijes në organizatë.
- Do të jenë në gjendje të demonstrojnë diturinë e tyre , dhe ndikimin e kësaj diturie në produktivitetin e organizatës.
- Të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuri të plotë të njohjes së ligjeve të cilat kanë lidhje mbi mundësitë e barabarta të punës, dhe infrastrukturën ligjore të cilat janë nxjerr nga shteti, lidhur me punësimin, zhvillimin, kompensimin, pensionimin etj.

## Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Hyrje ne Menaxhimin e Burimeve Njerezore	Handbook of Human Resource Management Practice, Michael Armstrong, tenth edition; Menaxhimi i Burimeve Njerezore, Ymer Havolli.
2	Analiza e vendit te punes dhe planifikimi i burimeve Njerezore	
3	Procesi i Rekrutimit	
4	Testimi dhe Selektimi (perzgjedhja) i punetoreve	
5	Testimi dhe Selektimi i punetoreve	
6	Intervista si metode gjate perzgjedhjes se punetoreve	
7	Orientimi i punetoreve te rinj	
8	Trajnimi dhe Zhvillimi	
9	Vleresimi i performances dhe kompensimi	
10	Mundesite e barabarta dhe mosdiskriminimi; Siguria ne vendin e Punes;	

## Informata shtesë 1:

Lënda përsëritet nëse studenti nuk ka arritur të përvetësojë dhe demonstrojë në provimin përfundimtarë dhe punimin seminarit-rast studimor të përmbush 51% të syllabusit.

## Informata shtesë 2:

Mjete konkretizuese: Projektori për prezantime ndërsa aktivitet tjera te cilat janë pjese e këtij moduli sillen si raste studimore nga analiza qe i bëhen organizatave lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore. Mjete konkretizuese tjera; Raste studimore, analizat nga kompanitë te cilat rezultojnë nga hulumtimet e studenteve dhe rastet studimore. Këto Analiza diskutohen dhe debatoohen per secilin rast ne salle.

## Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Pjesëmarrja	20	Po	Pjesëmarrja dhe diskutimi
2	Prezentim	30	Po	Prezantim ekipor i nje rasti studimi
3	Provimi Final	50		Provim me shkrim mbi temat e mbuluara gjate ligjeratave

## Kushtet e përsëritjes:

Studenti i nënshtrohet provimit në afatin vijues, punimi seminarit ose rasti studimor nëse një herë janë pranuar, vlejné edhe për afatin tjetër. Nëse studenti nuk i ka plotësuar kriteret e hartimit të një seminari-metodologjinë dhe pjesën analitike atëherë do të kërkohet nga ai që edhe seminarit ta punoj sërish.

## Burimet:

**Burimet:**

- Literatura ne gjuhen shqipe: Ymer Havolli, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, 2014
- Literatura ne Anglisht: Michael Armstrong: Human resource Management Practice 8th edition 2001 H T Graham & Roger Bennett: Human Resources management, Great Britain 1998

**Ndërtimi i ECTS-ve**

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	(i)
Ushtrime:	1	(i)
L+U:	3	(i)
Seminar/praktike.:	65	(i)
Studim i vazhdushem:	35	(i)
Pregaditja e Provimit:	40	(i)
Pjesemarrja ne teste:	0	(i)
Pjesemarrja ne provimin final:	2	(i)
Me profesorin dhe asistentin:	10	(i)
Total Ore:	182	(i)
ECTS:	8	(i)